- Situacionin përfundimtar të objektit;
- Akt kolaudimi (në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;

Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
- Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e autoritetit kontraktor.

2.3.2 Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objekti të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:
  - N.P. 1- A Punime gjurmimi në tokë;
  - N.P. 2- E Ndërtime civile dhe industriale;
  - NP- 12A ( Punime te inxhinierise se Mjedisit);
  - NP-7- BUjesjelles, kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje;
- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:
  - N.S. 1- A Punime për prishjen e ndërtesave;
  - N.S -2- A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
  - NS-3 A(Impiante ngritëse transportuese);
  - N.S-4 - D Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese;
  - N.S-9 – A Punime strukturore speciale
  - N.S- 12 - B Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit ;
  - N.S- 14 –A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV;
  - N.S –18 - A Punime topogjeodezike.

*Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.*

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë license projektimi ose të kontraktojë me një operatore ekonomike projektuese të licensuar sipas rregullores së miratuar me VKM nr.943, datë 28/12/2016 "Përkriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim". Licenca e projektimit duhet të ketë kategorite si më poshtë :

- Kat. 2 b)2 qendra tregtare; objekte social- kulturore; objekte kulturi; objekte arsimore.
- Kat. 3 a) Objekte civile- industriale- turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate
- Kat. 4 a) Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.c) Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.f) Projektim të sistemeve kundër zjarrit.h) Projektim i impianteve ngritëse e transportuese (ashensor, shkalle levizëse etj.)j) Projektim të rrjeteve të telefonise, citofonise, fonise,internetit, tv, acces controll, CCTV, sistemet e alrmit, sistemet e detektimit të zjarrit etj, për objekte civile e industriale.
- Kat. 5. b) Furnizim me ujë- kolektor shkarkimi

Si deshmi duhet te dorezoje kontraten/marreveshjen me shoqerine projektuese dhe licencat perkatese te kerkuara.

*Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.*

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

2.3.4 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierike për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensen e shoqërisë ose të jenë të pajisur me licensë individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si më poshtë:

Stafi kryesor :

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Drejtuës teknik) profili strukture
- 3 (tre) Inxhinier Ndërtimi zbatues
- 2 (dy) Arkitekt
- 2 (dy) Inxhinier Mekanike
- 2 (dy) Inxhinier hidroteknike
- 2 (dy) Inxhinier gjeodet /Topograf/Markshajder/Gjeomatik
- 2 (dy) Inxhinier elektrik
- 1 (një) Inxhinier mjedisi
- 1 (një) Inxhinier gjeolog
- 1 (një) Inxhinier elektronike

Staf mbështetës :

- 1 (një) Inspektore Cilesie me background Inxhinierik
- 1 (një) specialiste te sigurimit dhe Shendetit ne pune (HSE)

Per stafin mbeshtetes operatori ekonomike duhet te paraqese diplome te vlefshme dhe/ose deshmi/certifikate/trajnim qe deshmon fushen e ekspertizes.



Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret e kerkuar ne piken 2.3.4 jane te paangazhuar ne kontrata te tjera.

2.3.5 Fuqia punëtore e operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit të jetë minimalisht 320punonjës të punësuar për periudhën Shkurt 2020–Korrik 2020. Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë;

a) Vërtetim të lëshuar nga adminstrata tatimore për periudhen Shkurt 2020–Korrik 2020 shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor.

2.3.6 Të ketë në stafin e tij të pakten 25 (njëzet e pese) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, kontrata e punes përkatëse ( te vlefshme) si me poshte:

- Teknik ndertimi 4 (kater)
- Karpentier 3 (tre)
- Elektracist 4 (katër)
- Mekanik 4 (katër)
- Hidraulik 4 (katër)
- Manovrator 6 (gjashtë)

Operatorët ekonomike duhet te paraqesin për 6 (gjashte) punonjesit manovratore dëshmi te aftësisë profesionale per mjetet e renda.

2.3.7 Mjetet dhe pajisjet teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 10(dhjete) ton dhe maksimumii 15(pesembedhjete) ton për secilin kamion	5 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5 (pese) ton dhe maksimumii 10 ( dhjete ) ton për secilin kamion	4 copë	Pronësi ose me qera
Elektrosaldatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	2 copë	Pronësi ose me qera
Vinç me kosh	1 copë	Pronësi ose me qera
Gazogjen	2 copë	Pronësi ose me qera
Tokmak Elektrik	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere 500l	3 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator thellesie	2 cope	Pronësi ose me qera
Elektroorgano	2 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	2 copë	Pronësi ose me qera

Kamioçinë (kapaciteti mbajtës deri ne 3.5 (tre pike pese) ton	4 copë	Pronësi ose me qera
Autobot	1 copë	Pronësi ose me qera
Depozitë uji (5000)	1 copë	Pronësi ose me qera
Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë)	1500 m2	Pronësi ose me qera
Rul me Vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator Saldimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Zmerilatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompe suvatimi	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinc	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrom me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me kove 0.5 m3	2 copë	Pronësi ose me qera
Moto Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinc Kulle	1 copë	Pronësi ose me qera

a) Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike do të paraqiten këto dokumente:

b) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatori, duhet të paraqiten:  
-kontratat e shitblerjes ose kontratat e qirasë.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- *çertifikatën e pronësisë;*
- *leja e qarkullimit;*
- *foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

ndërsa për mjete të marra me qira, duhet të paraqitet:

- kontrata e qirasë.*
- leja e qarkullimit*
- *çertifikatën e pronësisë*
- foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:  
- *kontrata e blerjes apo çdoganimit dhe faturat tatimore përkatëse,*

ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.

*Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës 13.*

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij:

- 1 (një) *Ekspert* për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomën, kontratën individuale të punës ( të vlefshme), si dhe çertifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij:

- 1 (një) *Ekspert* për mbrojtjen nga zjarri.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomën, kontratën individuale të punës ( të vlefshme), si dhe çertifikatën për mbrojtjen nga zjarri.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij:

- 1 (një) *auditues energjistik*

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomën, kontratën individuale të punës ( të vlefshme), si dhe çertifikatën për “Auditues energjistik”

2.3.11 Certifikatat e cilësisë që duhet të dorëzojnë operatorët:

- Operatori ekonomik duhet te paraqesë Certifikaten e cilesise se punimeve ISO 9001- 2015 e vlefshme
- Operatori ekonomik duhet te paraqesë Certificate ISO 14001-2015 e vlefshme
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë OHSAS 18001-2007 vlefshme (ekuivalente me ISO 45001-2018)

\*Te gjitha certifikatat e mesiperme duhet te jene te lëshuaranga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues. Pranohen standarti shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat e mesiperme ISO*

Operatoret e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën angleze ose gjuhën shqipe.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## Shtojca 17

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti përgjegjës)

## PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

## KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## Shtojca 18

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti përgjegjës)

## PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Kontraktori do të duhet të bëjë detajimin e projektit bazuar në materialet e vendosura në dispozicion nga AK. Operatorët ekonomike do të terealizojnë detajimin e hollësisht të projekt idese për objektin e prokurimit *pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.*

## Shtojca 19

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës ]

## GRAFIKU I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

1. Kohëzgjatja e kontratës për Ndërtimi i godinës Qendra Sociale "Të Qëndrojmë së Bashku", Kombinat është 4 muaj dhe 1 muaj për detajimin e dosjes së projekt zbatimit.
2. Kohëzgjatja e kontratës për Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.2 (Nr.3) është 14 muaj dhe 1 muaj për detajimin e dosjes së projekt zbatimit.
3. Kohëzgjatja e kontratës për Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.2 (Nr.4) është 14 muaj dhe 1 muaj për detajimin e dosjes së projekt zbatimit.

4. Kohëzgjatja e kontratës për Ndërtimi i godinës “Godina nr.22, blv. Zogu I (7-katëshi) është 8 muaj dhe 1 muaj për detajimin e dosjes së projekt zbatimit.
5. Kohëzgjatja e kontratës për Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 ( Nr.1) është 12 muaj dhe 1 muaj për detajimin e dosjes së projekt zbatimit.
6. Kohëzgjatja e kontratës për Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 ( Nr.2) është 12 muaj dhe 1 muaj për detajimin e dosjes së projekt zbatimit.
7. Kohëzgjatja e kontratës për Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 ( Nr.3) është 12 muaj dhe 1 muaj për detajimin e dosjes së projekt zbatimit.
8. Kohëzgjatja e kontratës për Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 ( Nr.4) është 12 muaj dhe 1 muaj për detajimin e dosjes së projekt zbatimit.
9. Kohëzgjatja e kontratës për Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 ( Nr.5) është 12 muaj dhe 1 muaj për detajimin e dosjes së projekt zbatimit.
10. Kohëzgjatja e kontratës për Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 ( Nr.6) është 12 muaj dhe 1 muaj për detajimin e dosjes së projekt zbatimit.
11. Kohëzgjatja e kontratës për Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 ( Nr.7) është 12 muaj dhe 1 muaj për detajimin e dosjes së projekt zbatimit.
12. Kohëzgjatja e kontratës për Ndërtimi i godinës TIP në RSU Nr.3 ( Nr.8) është 12 muaj dhe 1 muaj për detajimin e dosjes së projekt zbatimit.
13. Kohëzgjatja e kontratës për “Ndërtimi i shkollës “Sami Frashëri” është 10 muaj dhe 1 muaj për detajimin e dosjes së projekt zbatimit.
14. Kohëzgjatja e kontratës për “Ndërtimi i kopshtit “Fikas” është 2 muaj dhe 1 muaj për detajimin e dosjes së projekt zbatimit

Shtojca 20

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

#### NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>6</sup>

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Aktin Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” .

<sup>6</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---



---



---



---



---



---

Nëse mendoni se Autoriteti Përgjegjës ka shkelur Aktin Normativ gjatë procedurës së prokurimit publik për rindërtimin, atëherë kenë të drejtë të ankoheni siç parashikohet në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/2019.

Me respekt  
< Emri >

Shtojca 21

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës ]

#### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

\* \* \*

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it  
Emri i plotë i shoqërisë

2. \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it  
Emri i plotë i shoqërisë

Etj.

\* \* \*

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
 Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

\_\_\_\_\_

*numri i NUIS-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
 Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

\_\_\_\_\_

*numri i NUIS-it*

Janë skualifikuar operatorët ekonomikëtë mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*numri i NUIS-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë numri i NUIS-it* \_\_\_\_\_

Etj.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me \_\_\_\_\_ pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit*] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*].

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
 (nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit përgjegjës]

Shtojca 22

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit: \_\_\_\_\_

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____	
	<i>(me numra dhe fjalë)</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____	
	<i>(me numra dhe fjalë)</i>

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:



1. \_\_\_\_\_  
 Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
 (me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
 Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
 (me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
 (nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit përgjegjës]

Shtojca 23

### KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

Punët

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

## Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afatii realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Përgjegjës dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Përgjegjës se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Përgjegjës lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti KonPërgjegjëstraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për autoritetin përgjegjës.
- 2.15 “Autoritet Përgjegjës” do të thotë Autoriteti Përgjegjës qe është pjese e kesaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate.Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, qëfurnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.

2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Përgjegjës i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikati e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

4.1 Autoriteti Përgjegjës mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktori duhet të lejojë autoritetin përgjegjës të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Përgjegjës.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Përgjegjës duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Përgjegjës deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Përgjegjës të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Përgjegjës.

6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Përgjegjës zhvishjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Përgjegjës në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t’i japë Autoritetit Përgjegjës të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Përgjegjës.
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin përgjegjës siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Përgjegjës

- 11.1 Autoriteti Përgjegjës ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Përgjegjës ose të projekteve të Autoritetit Përgjegjës me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Përgjegjës nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Përgjegjës, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Përgjegjës.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Përgjegjës.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

14.2 Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi duhet të koordinojë me kontraktorët e tjerë zbatues në vendodhjen e punimeve sipas metodës që do të propozojë me qëllim ecurine dhe zbatimin brenda afatit të kontratës.

14.3 Kontraktori duhet të paraqesë planin e koordinimit tek drejtuesi i projektit për shqyrtim dhe miratin e tij.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

18.1 Autoriteti Përgjegjës duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Përgjegjës ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Përgjegjës dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

## Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara

22.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarise koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Përgjegjës.

## Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktori

23.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Përgjegjës do të jetë përgjegjës për:

- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Përgjegjës apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Përgjegjës, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Përgjegjës apo me projektin e tij.

## Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit

24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Përgjegjës sipas Nenit 23.

## Neni 25: Sigurimi

25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Përgjegjës dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Përgjegjës, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrisi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

25.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Përgjegjës.

## Neni 26: Testimet dhe Inspektimet

26.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspekteve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës

26.2 Autoriteti Përgjegjës me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin përgjegjës për të ndjekur këto teste dhe inspekte.

26.3 Autoriteti Përgjegjës gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspekte shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Përgjegjës do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Përgjegjës do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

